SHPiK

SHOQATA PROFESIONALE E INFORMATICIENTËVE TË KOSOVËS

KOSOVO INFORMATICS SOCIETY

BEBRAS Computing Challenge

# BEBRAS COMPUTING CHALLENGE

8 NËNTOR 2024 | 30 NËNTOR 2024

Sfida Bebras Computing Challenge 2024, e organizuar nga SHPIK, përfshiu me sukses mijëra nxënës nga shkollat e Kosovës, duke i sfiduar ata me detyra që zhvillojnë mendimin logjik dhe zgjidhjen e problemeve. Ky ishte viti i dytë që Kosova ishte pjesë e kësaj iniciative ndërkombëtare.



**1764** nxënës pjesëmarrës

**58** shkolla fillore dhe të mesme

**19** komuna nga e gjithë Kosova

**Sfida Bebras është një iniciativë që ka forcuar kulturën e mendimit kritik dhe kreativ nëpër shkolla, duke ofruar një platformë unike për nxënësit të shpalosin aftësitë e tyre në informatikë. Përzgjedhja dhe pjesëmarrja në finalen kombëtare ishin një dëshmi e përkushtimit të nxënësve dhe mësimdhënësve, duke e vendosur Kosovën në hartën ndërkombëtare të edukimit teknologjik.**

## 16 FINALISTË NGA SFIDA LOKALE

Nga 1764 pjesëmarrës në Sfidën Bebras lokale, vetëm 16 finalistë kaluan për të vazhduar garën në finalen që u mbajt më 30 nëntor 2024 në Prishtinë. Këta finalistë shfaqën shkathtësi të shkëlqyera në zgjidhjen e problemeve, duke konkurruar në një garë sfiduese dhe emocionuese.





## FITUESIT E FINALES

1. Neo Spahiu SHMU "Mustafa Bakija", Gjakovë
2. Arba Hamiti Shkolla Digjitale, Ferizaj
3. Art Berisha SHFMU "Bahri Kuqi", Vushtrri

admin@shpik.org www.shpik.org 044 507 575

SHPiK

SHOQATA PROFESIONALE E INFORMATICIENTËVE TË KOSOVËS

KOSOVO INFORMATICS SOCIETY

BEBRAS Computing Challenge

# BEBRAS COMPUTING CHALLENGE 2024







## Falënderime

SHPIK shpreh mirënjohje për mësimdhënësit që mbështetën nxënësit gjatë kësaj sfide dhe për gjithë nxënësit që kontribuan me kreativitet dhe përkushtim.
Suksesi i kësaj sfide është rezultat i bashkëpunimit të përkushtuar ndërmjet shkollave dhe organizatorëve.

Suksesi i nxënësve në zhvillimin e mendimit logjik dhe shkathtësive kompjuterike
Sfida Bebras këtë vit mblodhi nxënës nga klasat 3-12, duke i ndarë në kategori sipas moshës dhe klasave përkatëse:

- Kastorët (8-10 vjeç)
- Benjaminët (10-12)
- Kadetët (12-14 vjeç)
- Juniorët (14-16 vjeç)
- Seniorët (16-18).







admin@shpik.org www.shpik.org 044 507 575